



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave  
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs  
Zyra e drejtorit të përgjithshëm

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	Shkresës datë 21/10/2019				
PËR/ZA/TO:	Myrvete Gashi, Udhëheqëse e Departamentit-ZKA;				
CC:	Vlora Mehmeti Spanca -Ndihmës Auditor i Përgjithshëm.				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	N/A				
NGA/OD/FROM:	Bahri Berisha-Drejtor i Përgjithshëm i DK				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Veprimit-Raporti i Auditimit "Sistemi i Kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës"				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Tel & Fax (+ 383 38) 540 350 /540 836	Lokacioni: Kucni: Extension:	Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri ,Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë	Data: Datum: Date:	18.11.2019
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/as requested					X

E nderuara znj Gashi,

Fillimisht ju falënderoj për bashkëpunimin si dhe për finalizimin e Raportit të auditimit të performancës "Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të cilësisë së derivateve të naftës".


Bazuar në shkresën tuaj të pranuar nga Institucioni i Doganës së Kosovës me datën 21 Tetor 2019 kërkohet që, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi Dogana e Kosovës duhet të përgatis Planin e Veprimit me masat që do të ndërmarrim për adresimin e rekomandimeve të dhëna në këtë Raport të auditimit.

Gjithnjë kemi potencuar se Rekomandimet ë dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit na ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së punës sonë dhe avancimin e mëtutjeshëm të institucionit tonë.

Më poshtë gjeni edhe masat e marruara në këtë periudhë dhe në periudhën në vazhdim për Implementimin e Rekomandimeve të dhëna në Raport Final.

Jeni të mirëseardhur në auditimet e radhës!

Me respekt:  
Bahri Berisha  
Drejtor i Përgjithshëm  
Dogana e Kosovës



Prishtinë  
18 Nëntor 2019



Te gjeturat	Rekomandimi	Personat/Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit	Masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimit.	Afati i zbatimit
E gjetura 1	Të përpiloj procedura të qarta në të shkruar për të gjitha qasjet e përdoruesve në sistemin Asycuda dhe të sigurohet se këto procedura janë të zbatueshme për të gjithë përdoruesit e sistemit.	Sektori i Laboratorit Sektori i AW	<p>Qasjet në sistemi ASYCUDA World janë të rregulluar ashtu siç kërkohet me standardin 27002. Të gjitha qasjet janë të rregulluara në bazë të Funkcionit, Roleve dhe Procedurave që duhet të ndiqen nga zyrtarët në të gjitha procedurat doganore. Çdo veprim që bëhet nga personeli që ka qasje në sistem regjistrohen në sistem.</p> <p>Sidoqoftë, Dogana e Kosovës do të përpiloj dokumentin me të gjitha qasjet e përdoruesve të sistemi ASYCUDA sipas rekomandimit të dhënë nga ZKA dhe dokumenti do jetë i gatshëm brenda muajit Tetor 2019. Dokumenti është krijuar dhe është dinamik qe ndryshon varësisht qasjeve qe ndryshohen ne sistem.</p>	Është Implementuar.
E gjetura 2	Të lejohet autoboti i importuar i derivateve të naftës, i cili është përzgjedhur për ekzaminim fizik dhe testim laboratorik (kanal të kuq), për kalim të lirë (kanal të gjelbër) në treg të brendshëm vetëm	Sektori i Laboratorit Sektori AW	<p>Në vitin 2019 të gjitha proceset kanë qenë të bashkangjitura. Kjo shihet edhe nga raporti i auditimit.</p> <p>Është rregulluar edhe ri kanalizimi i deklaratave IM9 të cilat me herët për shkaqe teknike nuk kemi mundur ti bashkëngjisim.</p>	Është Implementuar.

	atëherë kur i është nënshtruar testimit laboratorik dhe ky raport me rezultate është ngarkuar në sistem (nën supozimin se rezultatet laboratorike kanë dal konforme).			
E gjetura 3	Laboratori i Doganës t'i nënshtrohet procesit të akreditimit në pajtim me standardit ISO/IEC 17025 për kompetencën e testimeve dhe kalibrimit të laboratorëve, për tu pajisur me certifikatën e akreditimit në Drejtorinë e Akreditimit për të gjithë parametrat që ka për qëllim t'i testoj në mënyrë që të rrisë besueshmërinë e rezultateve të testimeve që kryhen nga ky laborator dhe të vërtetoj kompetencën e tij si laborator.	Sektori i Laboratorit, D.Sh.P, Prokurimi, Financat.	Asnjë rregullore specifike e as udhëzim <u>nuk na obligon</u> që të jemi të akredituar. Dogana zbaton nenin 23 te UA 01/2017 te MTI për cilësi të karburanteve te lëngëta të naftës i cili nen nuk e obligon laboratorin e doganës që të jetë i akredituar, për deri sa për laboratorët privatë të cilat aplikojnë për autorizim nga MTI akreditimi është i obliguar. Ndërrimi i versionit te standardit 17025:2007 në 17025:2017 si dhe pengesat për servisimin e pajisjes për matje të karakteristikave te distilimit kanë bërë që të vonohemi me akreditim.  Laboratori doganor i ka ndërmarr veprimet e nevojshme me qëllim të akreditimit të laboratorit duke iniciuar procedura të prokurimit për angazhimin e një konsulencë për përgatitje dhe implementimin e kërkesave dhe kriterëve sipas	Afati për akreditim të laboratorit është fundi i muajit Shkurt 2020 (nëse përfundon aktiviteti i prokurimit për angazhim të konsulentit).

			<p>standardit SK EN ISO 17025:2017.</p> <p>Laboratori është në përgatitje të dokumenteve të akreditimit dhe gjithashtu është në proces të blerjes së pajisjeve të reja analizuese dhe pas këtij procesi laboratorit do të aplikoj për akreditim menjëherë pas liferimit të pajisjeve të reja, pranimit të tyre teknik, trajnimit të stafit përpilimit të udhëzimeve të reja të punës.</p>	
E gjetura 4	<p>Të bëhet azhurnimi i bazës së të dhënave të Laboratorit të Doganës e cila përmban të dhënat mbi secilën Trupë Inspektuese që ka bërë marrjen e mostrave, si dhe çdo raport i procesit mbi marrjen e mostrës si nga Dogana ashtu edhe nga Trupat Inspektuese të jetë i bashkëngjitur si dokument i skanuar në sistem.</p>	<p>Sektori i Laboratorit</p> <p>Degët Doganore</p>	<p>Sektori i Laboratorit dhe Degët Doganore do të evitojnë këtë të gjetur ashtu që procesi i marrjes së mostrave të doganës dhe ai i trupës inspektuese do të bashkëngjiten në sistemin Asycuda.</p> <p>Në protokoll kjo është rregulluar ku evidentohen edhe trupat inspektuese që kanë kryer mostrimin. Bashkëngjitja e këtyre dokumenteve të skanuar në sistem duhet të bëhet nga D.D.</p>	<p>Pjesa e laboratorit është Implementuar.</p> <p>Dhjetor 2019</p>
E gjetura 5	<p>Të merren veprimet e nevojshme në</p>	<p>Sektori i Laboratorit</p>	<p>Laboratori është në proces të blerjes së instrumenteve që përkrahin metodat</p>	<p>Dhjetor 2019</p>

	<p>drejtim të shtimit të parametrave të cilësisë së derivateve të naftës në atë mënyrë që përmbushen kërkesat e Udhëzimit, mirëpo edhe të prioritizohen ata parametra që konsiderohen të rëndësishëm në përcaktimin e cilësisë së derivateve.</p>		<p>standarde të testimit të parapara me standardet në të cilat bazohet UA 01/2017.</p> <p>Secili parametër ka rëndësinë e vet, qoftë për punë te motorit apo për qëllime ambientale përndryshe nuk do të futej në standardet EN 228 dhe 590 megjithatë ata te cilit i kemi konsideruar me prioritet i kemi planifikuar gjithnjë varësisht nga mundësitë buxhetore.</p> <p>Është nënshkruar kontrata dhe pritet të bëhet liferimi i pajisjeve të reja analizuuese në fillim të muajit Dhjetor ku edhe do të shtohet numri i parametrave që do të testohen per cilësi si: distilimi, index cetanik dhe CFPP</p>	
E gjetura 6	<p>Të funksionalizohet sa më shpejtë që është e mundur pajisja që teston parametrin e Distilimit, si dhe deri në funksionalizim të këtij parametri, Laboratori i Doganës të bëjë testimin e parametrin tek laboratorët vendorë të cilët janë të akredituar dhe autorizuar</p>	Sektori i Laboratorit	<p>Laboratori ka planifikuar blerjen e një pajisje tjetër të distilimit e cila për verifikim te cilësisë pa problem përkrah standardin EN ISO 3405 dhe temperatura më të larta të nxehjes për shkak te matjes së karakteristikave të distilimit të derivateve me qëllim të klasifikimit tarifor. Dërgimi i secilës mostre te ngarkesave te selektuara tek laboratorët vendor përpos qe është i pa nevojshëm (pasi qe vetëm një rast prej vitit 2017 deri me tani është ka qene jo konform për këtë</p>	Dhjetor 2019.

	<p>për të bërë testimin e tij.</p>		<p>parametër). Kjo gjithashtu shkakton shpenzime të tepërta të pa nevojshme analizuese, mos përkrahje nga mundësitë tona buxhetore dhe burimet njerëzore, shpenzime logjistike, pritje të gjata për importuesin, ndikim në performancës e Doganës sa i përket kohës se zhdoganimit, futje në sistem te dy raporteve te testimet etj. Si zgjidhje kishte me qene dërgimi i ngarkesave të secilit kontingjent deri në momentin e blerjes se pajisjes së re për matje të distilimit.</p> <p>Pajisja për distilim do të zëvendësohet me pajisje të re e cila pritet të liferohet së bashku me pajisje tjera dhe të lëshohet në punë në fillim të muajit</p>	
--	------------------------------------	--	---	--